

V E N D I M
Nr. 73, datë 15.2.2001

**PËR KRITERET DHE MASËN E TRAJTIMIT TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE
QË KANË PUNUAR NË MINIERË, NËNTOKË**

(Ndryshuar me VKM nr. 374 ,datë 27.5.2001)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësit që kanë punuar në miniera në nëntokë, në rastet kur për llogaritjen e bazës së vlerësuar mungojnë dokumentet, niveli minimal i përfitimit të jetë 5 148 lekë.

2. Punonjësit, të cilët përfitojnë trajtim të veçantë, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- a) kërkesën për përfitim;
- b) çertifikatën e lindjes, me fotografi;
- c) çertifikatën e gjendjes familjare;
- ç) librezën e punës;
- d) vërtetimin për periudhën e sigurimit dhe për periudhën që ka punuar nëntokë;
- dh) deklaratën personale, nëse ushtron veprimtari ekonomike ose jo;
- e) vërtetimin nga zyra e tatim-taksave, për regjistrimin ose jo, si person fizik apo juridik, të tatueshëm;
- ë) vërtetimin nga zyra e punës, nëse është i regjistruar ose jo, si i papunë ose përfiton pagesë papunësie;

f) vërtetimin e bazës së vlerësuar.

1.1 Për efekt trajtimi sipas këtij ligji, punonjës që kanë punuar në miniera në nëntokë konsiderohen punonjësit e nëntokës të minierave, të ndërmarrjeve të ndërtim-minierave dhe të gjeologjisë.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Minierave, në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, paraqet, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, listën e minierave, që nuk ushtrojnë veprimtari dhe që nuk kanë administratë pranë tyre. Kjo Drejtori paraqet, një herë në muaj, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore edhe të dhëna për numrin e përfituesve, në shkallë vendi.

4. Administratat e minierave të dërgojnë pranë agjencive të sigurimeve shoqërore, listëpagesat, për të cilat janë derdhur kontributet për sigurimet shoqërore dhe listëpagesat për periudhat, për të cilat janë debitore ndaj sigurimeve shoqërore.

5. Personat, që plotësojnë kushtet për përfitimin e trajtimit të veçantë, paraqiten pranë agjencive të sigurimeve shoqërore të vendbanimit apo të vendit të fundit të punës së tyre, ku do të pajisen me dy kopje të kërkesës për përfitim.

6. Personat të paraqesin, në agjencitë e sigurimeve shoqërore, dokumentet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “dh”, “e” dhe “ë”, të pikës 2 të këtij vendimi.

7. Personat të paraqesin, në administratën e minierës ku ka qenë vendi i fundit i punës, një kopje të kërkesës për përfitim. Administrata, pasi e shqyrton dokumentacionin për periudhën e sigurimit, periudhën e punës nëntokë dhe bazën e vlerësuar mbi të ardhurat e realizuara nga puna të personit e interesuar, i plotëson ato dhe i dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Minierave, në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

8. Në rastet kur miniera, ku personi ka patur vendin e fundit të punës, është mbyllur, kërkesa për përfitim paraqitet në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivës së Shtetit, apo në drejtorinë e arkivës në rreth, ku është dokumentacioni i kësaj miniere. Këto drejtori, pasi e shqyrtojnë

dokumentacionin për periudhën e sigurimit, periudhën e punës nëntokë dhe bazën e vlerësuar mbi të ardhurat e realizuara nga puna e personit të interesuar, i plotësojnë ato dhe i dërgojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Minierave, në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Minierave në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, pasi verifikon dokumentacionin e paraqitur nga administrata e minierës apo nga drejtoritë e arkivave të shtetit, dërgon në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore, ku është paraqitur kërkesa e personit për përfitim, këto dokumente:

a) vërtetimin për periudhën e sigurimit dhe për periudhën e punuar nëntokë;

b) vërtetimin e bazës së vlerësuar mbi të ardhurat e realizuara nga puna.

10. Dokumentacioni, që autorizon dhe vërteton pagesën e përfitimeve, në zbatim të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, përcaktohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i cili, për këtë punë, përfiton një komision, në masën prej 1.5 për qind të shumës së përcaktuar për pagimin e përfitimeve.

11. Pas paraqitjes së listës së punonjësve, nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave përcakton fondin e nevojshëm për përballimin e trajtimit të veçantë.

12. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta